



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Dialogu i Nivelit të Lartë Kosovë – BE për Prioritetet Kyçe
– Agjenda për Reforma Evropiane (ARE) –

Nëntor 2016
Prishtinë

Faqe e zbrahtë

Përmbajtja

Vendimi i Qeverisë për miratimin e ARE 4

HYRJE 5

I. Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit 7

II. Konkurrueshmëria dhe Klima e Investimeve 8

III. Punësimi dhe Arsimi 10

Plani i Veprimit për Zbatimin e Prioriteteve Kyçe (siç është prezantuar nga Qeveria) 11



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/115

Datë: 09.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 9 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Agjenda për Reforma Evropiane (ARE).
2. Për zbatimin e ARE obligohen të gjitha institucionet përgjegjëse sipas Planit të Veprimit.
3. Buxheti për zbatimin e Planit të Veprimit të ARE duhet të mbetet brenda ndarjeve buxhetore të organizatave buxhetore për vitin 2016 dhe 2017 dhe në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.
4. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian të inkorporojë në ARE të gjitha komentet eventuale relevante të pranuar nga Komisioni Evropian dhe institucionet respektive të linjës.
5. Dokumentin nga pika 1. e këtij vendimi, obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që ta procedojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

HYRJE

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet BE-së dhe Kosovës ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016. Marrëveshja është marrëdhënia e parë zyrtare kontraktuale që lidh së bashku BE-në dhe Kosovën. Ajo i ofron Kosovës mundësi dhe stimuj që të forcojë qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit, si dhe të nxisë rritjen ekonomike dhe punësimin. Ajo siguron zhvillimin gradual të një zone të tregtisë së lirë me BE-në, mund të ndihmojë në tërheqjen e investimeve të huaja dhe të brendshme, dhe të përmirësojë mjedisin afarist.

Më 17 maj, Kryeministri Mustafa dhe Komisionieri Hahn u pajtuan për zhvillimin e ‘Agjendës për Reforma Evropiane’ për të maksimizuar përfitimet ekonomike dhe politike të MSA-së. Për këtë qëllim janë dakorduar prioritetet afatshkurtra në fushat e (I) qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, (II) konkurrueshmërisë dhe klimës së investimeve, dhe (III) arsimit dhe punësimit.

Agjenda për Reforma Evropiane duhet të shihet si e ndërlidhur me Programin e Kosovës për Reforma Ekonomike, i cili i është dorëzuar Komisionit në janar 2016 dhe mbetet dokumenti kyç gjithëpërfshirës i politikave që udhëheq reformat makro-ekonomike dhe fiskale, përfshirë rekomandimet për përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe zbutjen e trysnisë në tregun e punës. Konkluzionet e përbashkëta të dala me rastin e takimit Ministror për Dialogun Ekonomik dhe Financiar ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor e Turqisë, në maj 2016, ofrojnë udhëzime politikash me pikësnyime të qarta, të cilat duhet të zbatohen nga ana e Kosovës.

Përgjithësisht pranohet se në mënyrë që Kosova ta shfrytëzojë plotësisht MSA-në dhe mundësitë ekonomike që ofron ajo, ajo duhet të shoqërohet me reforma urgjente ekonomike (siç është përcaktuar në Programin e Reformave Ekonomike), si dhe të përcillet me sundim të ligjit. Institucionet e fuqishme dhe efijente, gjyqësori i pavarur dhe me resurse të duhura, si dhe vullneti politik për ta luftuar fuqishëm korrupsionin, janë kyçe për zhvillim, rritje ekonomike dhe punësim. Nevojitet përkushtim i vendosur nga ana e udhëheqësve politikë të Kosovës ndaj këtyre reformave, reforma këto që do të krijojnë mundësi reale për të gjithë shoqërinë.

Kosova aktualisht po përballlet me sfida në priorizim dhe planifikim, si në aspektin afatshkurtër, ashtu edhe në atë afatgjatë, për të siguruar zbatim efektiv. Agjenda për Reforma Evropiane në asnjë mënyrë nuk zëvendëson strategjitë ekzistuese^[1]. Përkundrazi, ajo synon të ndihmojë në priorizimin e veprimeve specifike që mund të realizohen në afat të shkurtër për të siguruar përkushtimin e Qeverisë së Kosovës përmes ndarjes adekuate të burimeve, si dhe të angazhimit të akterëve të tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë. Rrjedhimisht, Agjenda synon të shfrytëzojë plotësisht mundësitë e ofruara nga MSA.

Veprimet prioritare në kuadër të Agjendës për Reforma Evropiane janë identifikuar bashkërisht nga Qeveria e Kosovës dhe Komisioni Evropian, në konsultim të ngushtë me INF-të, sektorin e biznesit, shoqërinë civile dhe partnerët socialë¹.

^[1] Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (dhjetor 2015) dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (janar 2016).

¹ Si çështje ndër-sektoriale, bazuar në konsultimet me OShC-të, është e rëndësishme të sigurohet që Rregullorja për Standardet Minimale për Konsultime Publike të zbatohet plotësisht lidhur me veprimet dhe treguesit prioritarë të përcaktuar në Agjendën për Reforma Evropiane. Duhet të bëhen përpjekje që shoqëria civile të jetë e informuar për

Dialogu i Nivelit të Lartë mbi Agjendën për Reforma Evropiane do të mbahet (dy) njëherë në vit për të vlerësuar dhe shqyrtuar përparimin e bërë. Takimet e këtij dialogu do të kryesohen nga Komisioneri, nga pala e Komisionit, dhe Kryeministri dhe ministrat e përzgjedhur të Qeverisë, nga pala e Kosovës. Monitorimi dhe raportimi i rregullt do të bëhet përmes dialogut të MSA-së, i cili do të fillojë pas mbledhjes së parë të Këshillit të SA-së me Kosovën, e cila do të mbahet në vjeshtë 2016. Prioritetet do të përditësohen, sipas nevojës, një herë në vit.

Realizimi i veprimeve prioritare do të ndihmojë në zbatimin e MSA-së dhe në avancimin e Kosovës në rrugën e saj evropiane.

veprimet e parapara nga Qeveria e Kosovës në zbatimin e saj. Për më tepër, zbatimi i Agjendës për Reforma Evropiane duhet të realizohet në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore.

I. Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit

Një nga sfidat më të mëdha për Kosovën është sektori i sundimit të ligjit me një numër çështjesh të përsëritura siç është pavarësia e gjyqësorit, korrupsioni etj.

Për prioritetet e menjëhershme² dhe afatmesme³ në këtë fushë, Kosova duhet të fokusohet në:

1. Rishikimin dhe miratimin e legjislacionit duke e bërë të detyrueshëm pezullimin dhe/ose largimin e zyrtarëve publik, përkatësisht të akuzuarve dhe të dënuarve për korrupsion
2. Ndryshimin e ligjit për konfliktin e interesit dhe rregulloret përkatëse duke i sjellë ato në përputhshmëri me standardet evropiane dhe që tregojnë rrethanat e sakta ku zyrtarët publik mund të angazhohen në punë shtese dhe të emërohen
3. Sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies së fondeve për partitë politike:
 - a. Kryerjen e auditimeve të pavarura të financave të partive politike për vitet 2013-2015
 - b. Sigurimin e publikimit të raporteve financiare të partive politike, siç parashihet me ligj
4. Kryerjen e një analize të pavarur të mekanizmave llogaridhënës së të gjitha institucioneve të pavarura, agjencive dhe organeve rregullative dhe miratimi i masave legjislative që në mënyrë të qartë përcaktojnë rolet, përgjegjësitë dhe linjat e llogaridhënies së këtyre institucioneve
5. Sigurimin që pakoja e planifikuar legjislative që mbulon shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës shtetërore të përgatitet në mënyrë të bashkërenduar, në një proces gjithëpërfshirës dhe të bazuar në të dhëna empirike, bazuar në koncept-dokumentet e dakorduara në nivel të Qeverisë
6. Sigurimin e një procesi transparent, të bazuar në merita dhe jopolitik të përzgjedhjes, në harmoni me ligjin, për të gjitha institucionet e pavarura, agjencitë dhe organet rregullatore, si dhe në kompanitë publike, duke përfshirë dhe në veçanti lidhur me proceset e përzgjedhjes që janë të hapura, si dhe sigurimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve nga ana e Agjencisë kundër Korrupsionit
7. Zbatimi i vendimit të qeverisë së marsit 2016 për futjen e prokurimit elektronik të detyrueshëm, së bashku me afatet kohore të cekura
8. Forcimin e kapaciteteve të Departamentit për Çështje Ekonomike dhe Divizionit për Çështje Fiskal në Departamentin Administrativ të Gjykatës Themelore të Prishtinës, përfshirë fushat e tatimeve dhe doganave, me qëllim të zvogëlimit të rasteve të grumbulluara
9. Vazhdimin e përmirësimit të progresit në zbatim sa u përket rasteve të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përfshirë përmes fuqizimit të kapaciteteve të Prokurorisë Speciale në hetimin dhe ndjekjen e rasteve të nivelit të lartë

² Fundi i vitit 2016

³ Fundi i vitit 2017

II. Konkurrueshmëria dhe Klima e Investimeve

Kosova është ekonomi e vogël e bazuar në konsum, e mbizotëruar nga sektori i shërbimeve, me integrim të kufizuar ndërkombëtar dhe varshmëri të lartë në asistencën nga donatorët dhe remitencat. Deficiti tregtar është shumë i lartë (2.3 miliardë euro në vitin 2015), me bazë prodhimit mjaft të ngushtë dhe ende jo-konkurruese. Dobësitë strukturore kufizojnë zhvillimin ekonomik afatgjatë të Kosovës, duke përfshirë krijimin e tregut funksional të punës ku do të ofroheshin më tepër mundësi punësimi. Ndër sfidat kryesore për Kosovën janë nevoja për ngritjen e bazës së saj të prodhimit, zhvillimi i kapaciteteve eksportuese dhe mbyllja e boshllëkut të konkurrueshmërisë, trajtimi i ekonomisë joformale dhe përmirësimi i mjedisit afarist, me qëllim të krijimit të një klime më të mirë të investimeve. Krijimi i një sistemi të transportit të bazuar në treg, ndërmarrja e hapave të nevojshëm për ta hapur tregun e energjisë dhe sigurimi i furnizimit të besueshëm me energji elektrike janë gjithashtu me rëndësi jetike për konkurrueshmërinë e Kosovës dhe agjentë të rritjes.

Për prioritetet e menjëhershme⁴ dhe afatmesme⁵ në këtë fushë, Kosova duhet të fokusohet në:

1. Promovimin e investimeve të huaja direkte:
 - a. Ngritjen e konsiderueshme të kapaciteteve dhe përmirësimin e organizimit të brendshëm të portofolit së Agjencisë për Investime në Kosovë për të lejuar atë që të përmirësoj punën e saj për promovimin dhe mbështetjen e investimeve, sektorit privat dhe zhvillimit të NVM-ve
 - a. Krijimin e një programi për shërbime dhe përkujdesje të mëtutjeshme të investitorëve për investitorët potencial dhe një mekanizëm të ankimimit të investitorëve që ka kompetenca të mjaftueshme për të ofruar shërbime të tilla
2. Përmirësimin e mjedisit afarist:
 - a. Përqendrimin në përmirësimin e treguesve të Bankës Botërore së ‘të bërit biznes’
 - b. Harmonizimin e rregullave me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, auditimit dhe raportimit financiar
 - c. Reduktimin e barrës rregullative për kompanitë, veçanërisht duke i bërë transparente tarifat dhe procedurat e nevojshme për të marrë leje dhe licenca
 - d. Vënien në fuqi të ndryshimeve legjislative për të përmirësuar menaxhimin, bashkërendimin dhe zbatimin e mbikëqyrjes së tregut
 - e. Harmonizimin e legjislacionit, përmirësimin e kapaciteteve të organeve të konkurrencës dhe ndihmës shtetërore, dhe sigurimin që të fillojnë të zbatojnë mandatet e tyre.
3. Zbatimin sistematik të strategjisë së miratuar dhe planit të veprimit për të luftuar ekonominë joformale

⁴ Fundi i vitit 2016

⁵ Fundi i vitit 2017

4. Mbështetjen për zhvillimin e NVM-ve:
 - a. Ndërmarrjen e masave pasuese bazuar në rekomandimet e të vlerësimit të ‘Aktit të biznesit të vogël’
 - b. Miratimin e masave konkrete për të përmirësuar infrastrukturën dhe standardet e cilësisë
 - c. Venin në fuqi të programeve dhe instrumenteve të eksportit për t’u ndihmuar NVM-ve që të integrohen në zinxhirët e vlerave globale për të mbështetur ndërkombëtarizimin e tyre
 - d. Miratimin e masave për të thelluar dhe zgjeruar ndërmjetësimin financiar, me qëllim të rritjes së qasjes në financa për NVM-të
5. Zhvillimin e mëtejshëm të një numri statistikash sektoriale që janë kyçe për bërjen e politikave në fushën e llogarive kombëtare, statistikave tregtare dhe atyre afariste, të energjisë dhe atyre sociale.
6. Përmirësimin e ndërlidhshmërisë rajonale:
 - a. Zbatimin e projekteve prioritare individuale të investimeve publike, në veçanti duke miratuar raportin e rishikuar për zbatimin e klauzolës së investimeve, në bazë të ‘listës prioritare të projekteve infrastrukturore’
 - b. Zbatimin e të gjitha ‘masave të buta’ të lidhjeve të mbetura dhe reformave përkatëse të politikave mbi transportin dhe energjinë
7. Përmirësimin e sigurisë së energjisë dhe miratimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të energjisë për periudhën 2017-2026:
 - a. Marrjen e vendimit për modalitetet e pronësisë për Kosovën B dhe për investime të reja në prodhimin e energjisë dhe për dekomisionimin e Kosovës A
 - b. Miratimin e një plani të përditësuar të veprimit për energjinë e ripërtërishme
 - c. Vlerësimin e modaliteteve më të mira për krijimin e mekanizmit për financimin e efikasitetit të energjisë dhe masave mjedisore në sektorin publik dhe ata të banimit si dhe promovimi i përdorimit të plotë të iniciativave ekzistuese, siç është Programi Rajonal për Efikasitetin.

III. Punësimi dhe Arsimi

Kosova përballlet me sfida të konsiderueshme në zhvillimin e tregut të saj të punës. Integrimi i më shumë njerëzve në punësim përbën thelbin e sfidave socio-ekonomike, si në aspektin e ofertës, ashtu edhe atë të kërkesës. Kosova ka një shkallë shumë të ulët të pjesëmarrjes në tregun e punës, e cila sillet te rreth 40%, me boshllëqe të theksuara ndërmjet meshkujve (61.8%) dhe femrave (21.4%). Shkalla e punësimit është 41.3% te meshkujt dhe 12.5% te femrat. Kështu, shkalla e papunësisë është shumë e lartë (33.1%, te meshkujt, 41.6% te femrat). Përfshirja e dobët e të rinjve në tregun e punës përbën brengë të veçantë. Vetëm 9% e të rinjve nën moshën 25-vjeçare janë të punësuar.

Kosova i ka 20 institucione të arsimit të lartë për 1 milion banorë, gjë që tejkalon mesataren e Bashkimit Evropian. Megjithatë, ka nevojë urgjente që të reformohet sektori i arsimit dhe që të ndërlihet arsimi dhe aftësimi pas nivelit të mesëm me boshllëqet në tregun e punës. Megjithatë, meqë shkathtësitë themelore dhe 'të buta' zakonisht zhvillohen gjatë arsimit themelor, duhet të përmirësohet cilësia e arsimit parauniversitar.

Për prioritetet e menjëhershme dhe afatmesme në këtë fushë, Kosova duhet të fokusohet në:

1. Miratimin dhe zbatimin e Strategjisë Sektoriale për Punësim dhe Politikën e Sociale 2015 – 2020 dhe miratimin e Planit të Veprimit 2017 – 2018 për zbatimin e strategjisë
2. Përmirësimin e mundësive të punësimit:
 - a. Hartimin e një plan të veprimit për trajtimin e papunësisë së të rinjve, bazuar në vlerësimin e sfidave, dhe përqendrimin në përmirësimin e rezultateve të arsimit dhe mbështetjes së kalimit nga shkolla në punë
 - b. Ndërmarrjen e masa për të rritur pjesëmarrjen e grave në tregun e punës
3. Sigurimin e zbatimit të Ligjit për Agjencinë e Punësimit, në veçanti përmes funksionalizimit të plotë të Agjencisë së Punësimit dhe ndarjes së buxhetit të nevojshëm për të siguruar që ajo të jetë në gjendje të zbatojë masa aktive të tregut të punës me rezultate të prekshme
4. Miratimin e legjislacionit të mbetur që siguron bazën për reforma të politikave në sektorin e arsimit
5. Përmirësimin e cilësisë së arsimit:
 - a. Rritjen e vijueshmërinë në arsimin parashkollor
 - b. Realizimin e vlerësimit/vlerësimit të jashtëm dhe përshpejtimin e zbatimit të kurrikulave të reja, përfshirë tekstet e reja shkollore në arsimin parauniversitar
 - c. Vendosjen e mekanizmave për të vlerësuar dhe përmirësuar programet e trajnimit fillestar dhe gjatë shërbimit të mësimdhënësve.
 - d. Përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të arsimit të lartë
 - e. Nxitjen e ndërlidhjes më të mirë ndërmjet arsimit të lartë dhe tregut të punës
6. Përmirësimin e cilësisë së Arsimit dhe Aftësimin Profesional, si dhe të kalimit nga shkolla në punë.

Plani i Veprimit për Zbatimin e Prioriteteve Kyçe (siç është prezantuar nga Qeveria)

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Afatet kohor	Institucionet përgjegjëse
I. Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit				
1.1	Rishikimi dhe miratimi i legjislacionit që e bënë të detyrueshëm pezullimin dhe/ose largimin e zyrtarëve publik të akuzuar dhe dënuar për korrupsion.	1. Koncept dokumenti mbi ndryshimin e legjislacionit në fuqi për të siguruar pezullimin dhe/ose largimin e detyrueshëm të zyrtarëve publikë të akuzuar dhe dënuar për korrupsion 2. Miratimi i legjislacionit për të siguruar pezullimin dhe/ose largimin e detyrueshëm të zyrtarëve publik të akuzuar dhe dënuar për korrupsion	K4 2016	MD Kryetari Kuvendi
1.2	Ndryshimi i ligjit për konfliktin e interesit dhe rregulloret e ndërlidhura, duke i harmonizuar me standardet evropiane dhe duke paraqitur kushtet e sakta në të cilat zyrtarët publik mund të kenë punësim apo emërim shtesë	1. Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike duhet të ndryshohet, në harmoni me rekomandimet e BE-së: a. duhet të përcaktohen qartë kategoritë e zyrtarëve publik; b. duhet të theksohen qartë aktivitete që zyrtarëve iu lejohet dhe iu ndaloher t'i kryejnë përderisa mbajnë postin; c. duhet të theksohen qartë aktivitete që zyrtarët e kanë të ndaluar t'i ushtrojnë pas përfundimit të mandatit; d. duhet të theksohen qartë obligimet e zyrtarëve dhe eprorëve të tyre në situata të konfliktit të interesit; e. duhet të theksohen qartë procedurat që duhet aplikohen pas paraqitjes së konfliktit të interesit.	K4 2016	MD Kuvendi
1.3	Sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies në financimin e partive politike: a. Realizimi i auditimeve të pavarura të financave të partive për vitet 2013-2015 b. Sigurimi i publikimit të raporteve	1. Publikohen raportet financiare të partive politike dhe të ndërmerren veprim efikas për zbatim kundër atyre që nuk e përmbushin këtë; 2. Të ofrohet financim adekuat për prokurimin e shërbimeve të auditimit për raportet	1-3: K4 2016,	ZKM, KQZ, Kuvendi (Kryesia, Komisioni për

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Afatet kohor	Institucionet përgjegjëse
	financiare të partive politike, siç parashihet me ligj	financiare të partive politike; 3. Përzgjidhen auditorët e pavarur nëpërmjet thirrjes së hapur; 4. Ndryshohet ligji për financimin e partive politike për të siguruar transparencë, llogaridhënie dhe zbatim dhe sanksione efikase, në bazë të konsultimeve të gjera publike.	4: K4 2017	Mbikëqyrjen e Financave Publike, Sekretariati)
1.4	Realizimi i rishikimit të pavarur të mekanizmeve të llogaridhënies së të gjitha institucioneve të pavarura, agjencive dhe organeve rregullatore, përcjelljen e rekomandimeve të tyre dhe miratimin e masave legjislative që përcaktojnë qartë rolet, përgjegjësitë dhe linjat e llogaridhënies së këtyre institucioneve	1. Kryhet një analizë cilësore e agjencive të pavarura dhe agjencive të pavarura rregullatore (analiza mbi rregulloren e marrëdhënies së punës, pagave, themelimin dhe organizimin e agjencive); 2. Zotohet mbi zbatimin e rekomandimeve që dalin nga analiza cilësore; 3. Zhvillohet një koncept dokument për projektligjin mbi organizimin e administratës publike, shërbimin civil dhe pagat 4. Miratohet pakoja legjislative mbi shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike.	K4 2016 K4 2016 K4 2017	MAP Kuvendi MF ZKM
1.5	Sigurimi se pakoja e planifikuar legjislative, që mbulon shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës shtetërore, përgatitet në mënyrë të koordinuar në një proces gjithëpërfshirës dhe të bazuar në dëshmi në bazë të koncept dokumenteve të dakorduara në nivel qeveritar	1. Hartohen koncept dokumente për projektligjet mbi: shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike; dhe, 2. . Të miratohet pakoja legjislative mbi shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike.	K4 2016 K4 2017	MAP Kuvendi MF ZKM
1.6	Sigurimi i një proces i përzgjedhjes që është transparente, i bazuar në merita dhe jo-politik, në harmoni me ligjin, për të gjitha institucionet e pavarura, agjencitë dhe organet rregullative, si dhe në kompani publike; zbatimi i plotë i rekomandimeve nga Agjencia e Kosovës Kundër Korrupsionit (AKK-DLK-3113/15).	a. Ndryshimi i legjislacionit në fuqi për përzgjedhjen e institucioneve të pavarura për të siguruar procedura të fuqishme, transparente dhe të bazuara në merita të përzgjedhjes së kandidatëve: – Publikimi i CV-ve të kandidatëve në listë të ngushtë	a. 2016-2017	ZKM Kuvendi

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Afatet kohor	Institucionet përgjegjëse
		<ul style="list-style-type: none"> – Përfshirja e shoqërisë civile në komisionet përzgjedhëse, në bazë të një përzgjedhje transparente dhe të hapur të përfaqësuesve të shoqërisë civile; – Fuqizimi dhe qartësimi i kriterëve minimale për kandidatët përmes përfshirjes së kriterëve të ngjashme me nenin 17 paragrafi 2 i ligjit mbi NP-të, për shembull, në ndryshimet në ligjin mbi konfliktin e interesit, duke i bërë kështu të aplikueshme në të gjitha agjencitë e pavarura dhe organet rregullative. <p>b. Qeveria zotohet të veprojë sipas rekomandimeve të lëshuara nga AKK më datë 15.02.2016 (AKK-DLK-3113/15) në lidhje me emërimet në 9 borde të NP-ve:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Formulari/deklarata nën betim ndryshohet për të pasqyruar ligjin, për të gjitha emërimet e ardhshme – ZKM-ja ndërmerr veprim sipas nenit 17.5 të ligjit (d.m.th 17.5 Çdo person i cili mban ose aplikon për një pozitë të drejtorit duhet të japë një deklaratë nën betim në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisht dhe ato të përshtatshmërisë profesionale sipas paragrafëve 1-3 të këtij neni. Çdo përgënjeshttrim material – qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca – ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në 	b. K4 2016	

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Afatet kohor	Institucionet përgjegjëse
		<p>shkualifikimin e menjëhershëm dhe, nëse është e aplikueshme, largimin e personit.)</p> <ul style="list-style-type: none"> – ZKM-ja ndërmerr veprime kundër zyrtarëve që kanë hartuar këtë formë/deklaratë që nuk është në përputhje me ligjin. – Sigurohet zbatimin e MM të nënshkruar ndërmjet Kuvendit, Qeverisë në njërën anë dhe Ambasadës së MB në Prishtinë në anën tjetër, për emërimet e anëtarëve të bordit të institucioneve të pavarura dhe agjencive. 		
1.7	Zbatimi i vendimit e qeverisë të muajit mars 2016 mbi futjen e prokurimit të detyrueshëm, së bashku me afatet kohore të përmendura aty	<ol style="list-style-type: none"> 1. Fillohet faza e dytë të pilot projektit të e-prokurimit 2. Zbatohen ndryshimet e ligjit të prokurimit në platformën elektronike 3. Trajtohen zyrtarët publik në nivel lokal 4. Certifikohen zyrtarët publik në nivel qendror 5. Certifikohen zyrtarët publik në nivel lokal 6. Testohen modulet elektronike të prokurimit 7. Hartohen udhëzimet operative mbi e-prokurimin. Qeveria duhet t'i ofrojë publikut të dhëna standarde të lexueshme nga makina në kohë reale të kontratave të prokurimit. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Korrik - Shtator 2016 2. Korrik - Dhjetor 2016 3. Korrik - Dhjetor 2016 4. Shtator 2016 5. Dhjetor 2016 6. 5 Shtator 2016 7. Shtator - Dhjetor 2016 	MF KRPP
1.8	Fuqizimi i kapaciteteve të Departamentit Ekonomik dhe Divizionit Fiskal në	KGJK do të realizojë një vlerësim të nevojave për rritjen e numrit të gjyqtarëve në Gjykatat	K1 2017	KGJK

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Afatet kohor	Institucionet përgjegjëse
	Departamentin Administrativ të Gjykatës së Shkallës së Parë në Prishtinë, përfshirë në fushat e tatimit dhe doganave, me qëllim të reduktimit të rasteve të grumbulluara	Themelore Ekonomike. Vlerësimi do të përcaktojë kostot e buxhetit, si dhe kapacitetet njerëzore të nevojshme për reduktimin e rasteve të grumbulluara në Gjykatat Themelore Ekonomike.		
1.9	Vazhdimi i fuqizimit të regjistrimit mbi luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, përfshirë nëpërmjet fuqizimit të kapacitetit të Prokurorisë Speciale që heton dhe ndjek penalisht raste të nivelit të lartë.	1. Plotësim-ndryshimi i Ligjit mbi Prokurorin e Shtetit për të mundësuar rritjen e numrit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale, për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit dhe krimin të nivelit të lartë. 2. Ofrimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të Prokurorisë Speciale për të kryer hetime financiare dhe për të konfiskuar pasuri.	K2 2017	MD IGJK
II. Konkurrueshmëria dhe Klima e Investimeve				
2.1	<p>Promovimi i investimeve të huaja direkte</p> <p>a) Fuqizimi në mënyrë të konsiderueshme i kapaciteteve dhe përmirësimi i organizimit të portfolios së brendshme të Agjencisë së Kosovës për Investime për t'i mundësuar përmirësimin e performancës për promovimin dhe mbështetjen e investimeve, sektorit privat dhe zhvillimit të NVM-ve</p> <p>b) Krijimi i një program të shërbimit dhe kujdesit</p>	<p>a.1. Shqyrtim i thellë i fushëveprimit të përgjegjësive të KIESA, aktiviteteve të saj dhe përsëkrimeve të punës;</p> <p>a.2. Ristrukturimi i KIESA për t'i mundësuar që të përmbush me efikasitet përgjegjësitë e saj dhe të zbatojë prioritetet, ndarjen e burimeve të duhura dhe rekrutimin e punonjësve të kualifikuar;</p> <p>a.3. Zhvillimi i kapaciteteve të personelit të KIESA për dizajnimin dhe zbatimin e shërbimeve dhe programeve;</p> <p>a.4. Themelimi i Bordit Këshillues në kuadër të KIESA me pjesëmarrjen e komunitetit biznesor dhe përfshirjen e fuqishme të Zyrës së Kryeministrit;</p> <p>b.1. Përgatitja dhe fillimi i zbatimit të</p>	<p>a.1. K1 2017</p> <p>a.2. K3 2017</p> <p>a.3. K3 2017</p> <p>a.4. K3 2017</p> <p>b.1. K4 2017</p>	MTI ZKM

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Afatet kohor	Institucionet përgjegjëse
	pasues për investitorët e mundshëm dhe mekanizmin e ankesës që ka kompetenca të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve të tilla	shërbimeve dhe programeve të kujdesit pasues për investitorët;		
2.2	<p>Përmirësimi i mjedisit biznesor</p> <p>a. Fokusimi në përmirësimin e treguesve të raportit “Të të bërit biznes” të Bankës Botërore</p> <p>b. Harmonizoni rregullat me standarde ndërkombëtare të kontabilitetit, auditimit dhe raportimit financiar</p> <p>c. Reduktimi i barrës rregullative ndaj firmave, në veçanti përmes bërjes transparente të tarifave</p>	<p>a.1. Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik lehtëson reformën e të bërit biznes duke u fokusuar në rezultatet dhe arritjet në takimet e saj të rregullta;</p> <p>a.2. Përmirësimi i renditjes për zgjidhjen e paaftësisë paguese nëpërmjet zbatimit efikas të kornizës ligjore për falimentimin;</p> <p>a.3. Shkurtimi i procedurave, kohës dhe kostos për marrjen e lejeve ndërtimore, përfshirë nëpërmjet ndryshimit të Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2013 për Përcaktimin e Procedurave për Dorëzimin dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore si dhe për Leje ndërtimore në K2 2017;</p> <p>a.4. Regjistrimi online i bizneseve është vënë në dispozicion;</p> <p>a.5. Numri biznesor është unifikuar;</p> <p>b.1. Ligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, i hartuar;</p> <p>b.2. Konsultimet publike me Shoqërinë Civile dhe partnerët zhvillimor, të mbajtura;</p> <p>b.3. Ligji, i miratuar nga Kuvendi;</p> <p>c.1. Ligji i ri për shoqëritë tregtare është konsultuar me shoqërinë civile dhe</p>	<p>a.1. 2016/2017</p> <p>a.2. K4 2017</p> <p>a.3. K4 2017</p> <p>a.4. K2 2017;</p> <p>a.5. K4 2017</p> <p>b.1. K4 2016</p> <p>b.2. K4 2016</p> <p>b.3. K1 2017</p> <p>c.1. K2 2017</p>	<p>MTI MMPH MF KGJK</p>

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Afatet kohor	Institucionet përgjegjëse
	<p>dhe procedurave të kërkuara për leje dhe licenca</p> <p>d. Prezantimi i ndryshimeve legjislativ për të përmirësuar menaxhimin, koordinimin dhe zbatimin e mbikëqyrjes së tregut</p> <p>e. Përafrimi i legjislacionit, përmirësimi i kapaciteteve të Organeve të Konkurrencës dhe Ndihmës Shtetërore dhe sigurohet që fillojnë zbatimin e mandatit të tyre</p>	<p>akterët relevantë dhe është miratuar;</p> <p>c.2. Legjislacioni sekondar i ligjit për shoqëritë tregtare, i miratuar;</p> <p>c.3. Regjistri Qendror Online për Licenca dhe Leje është përditësuar më tej, përfshirë tarifatat dhe procedurat e kërkuara për marrjen e lejeve dhe ngarkimi i formularëve të aplikimit në bazën e të dhënave;</p> <p>d.1. Ligji për inspektimet e përgjithshme i hartuar për të reformuar aspektet kryesore procedurale, institucionale dhe funksionale</p> <p>d.2 Konsultimet publike me shoqërinë civile dhe akterët tjerë relevant, të mbajtura;</p> <p>d.3. Ligji për inspektimet e përgjithshme, i miratuar;</p> <p>e.1. Fuqizimi i procedurave dhe kapaciteteve të brendshme në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës për realizimin e hetimeve</p> <p>e.2. Autoriteti i Konkurrencës duhet të hulumtojë dhe përgatis një raport mbi gjendjen aktuale të monopoleve në tregun në Kosovë, me rekomandimet e duhura</p> <p>e.3. Përafrohet dhe ndryshohet ligji për ndihmë shtetërore dhe përafrohet legjislacioni sekondar</p> <p>e.4. Siguroni pavarësinë operative dhe kapacitete të mjaftueshme për të</p>	<p>c.2. K4 2017</p> <p>c.3. K3 2017</p> <p>d.1. K3 2017</p> <p>d.2. K3 2017</p> <p>d.3. K4 2017</p> <p>e.1. K4 2016</p> <p>e.2. K4 2017</p> <p>e.3. K1 2017</p> <p>e.4. K1 2017</p>	

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Afatet kohor	Institucionet përgjegjëse
		përmirësuar efikasitetin e kontrollit të tij në ndihmën shtetërore		
2.3	Zbatimi në mënyrë sistematike i strategjisë dhe planit të veprimit të miratuar për luftimin e ekonomisë joformale	<ol style="list-style-type: none"> 1. Realizohen vlerësime të pavarura sektoriale të rrezikut, duke u fokusuar në sektorët më të cenueshëm ndaj ekonomisë joformale, krimeve financiare, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit (duke mbuluar aspektin gjinor) 2. Rishikohet Plani i Veprimit duke marrë parasysh të gjeturat nga vlerësimi i rrezikut 3. Përmirësohet më tej pajtueshmëria tatimore dhe zbatimin në mënyrë që të mbrohet interesi i fiskal i vendit, të sigurohen të drejtat e punonjësve dhe të sigurohet konkurrencë e drejtë në fushën e biznesit. 4. Fuqizohet qasja ndër-institucionale dhe mekanizmat në fushën kundër pastrimit të parave, krimit financiar, financimit të terrorizmit dhe korrupsionit, përfshirë parandalimin, hetimet, vlerësimet dhe operimet (me ndihmën e projektit IPA 2015) 5. Raporte të rregullta tremujore, të përgatitura, konsultuara dhe publikuara ** 	<p>1. K3 2017</p> <p>2. K3 2017</p> <p>3. K4 2016 / K4 2017</p> <p>4. K4 2017</p> <p>5. 2016/2017</p>	MF
2.4	Mbështetja e zhvillimit të NVM-ve a) Ndërmarrja e masave pasuese bazuar në rekomandimet e vlerësimit rreth ‘Aktit të Bizneseve të Vogla’	<ol style="list-style-type: none"> a.1. Struktura e koordinimit të ABV është themeluar, përfshirë pikat e kontaktit për secilën ministri; a.2. KIESA fuqizon përpjekjet e gjera koordinuese të qeverisë për zbatimin e 	<p>a.1. K4 2016</p> <p>a.2. K4 2017</p>	MTI

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Afatet kohor	Institucionet përgjegjëse
	b) Miratimi i masave konkrete për të përmirësuar infrastrukturën dhe standardet e cilësisë	<p>rekomandimeve nga vlerësimi i Aktit të Bizneseve të Vogla, përfshirë nëpërmjet takimeve të rregullta koordinuese</p> <p>b.1. Avancimi dhe përditësimi i rregullt i uebfaqes, për tu përdorur si një platformë informuese online për bizneset, përfshirë këtu dhe infrastrukturën e cilësisë.</p> <p>b.2. 10 punëtori, të organizuara me qëllim të informimit të bizneseve sa i përket infrastrukturës së cilësisë dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni specifik vertikal, përfshirë këtu dhe promovimin e uebfaqes si platformë informuese.</p> <p>b.3. Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve njerëzore në fushën e infrastrukturës së cilësisë, duke përfshirë mënyrën nëpërmjet trajnimit të stafit (organizimi i 30 moduleve të trajnimit) dhe organeve të vlerësimit të konformitetit.</p> <p>b.4. 1,500 standarde, të miratuara me fokus në zonën e harmonizuar.</p> <p>b.5. Laboratorët metrologjik ekzistues, të furnizuar me pajisje;</p> <p>b.6. Ligji mbi shërbime, i hartuar dhe konsultuar me shoqërinë civile dhe akterë tjerë relevant.</p> <p>b.7. Ligji mbi shërbime, i miratuar (transpozimi i pjesshëm i Direktivës 123/EC mbi shërbime);</p>	<p>b.1. K4 2017</p> <p>b.2. 2016/2017</p> <p>b.3. K4 2017</p> <p>b.4. K4 2017</p> <p>b.5. K4 2017</p> <p>b.6. K1 2017</p> <p>b.7. K2 2017</p> <p>b.8. K4 2017</p>	

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Afatet kohor	Institucionet përgjegjëse
	<p>c) Prezantimi i programeve dhe instrumenteve të eksportit për ndihmuar që NMV-të të integrohen në zinxhirët global të vlerës, me qëllim të mbështetjes së ndërkombëtarizimit të tyre</p> <p>d) Miratimi i masave për të thelluar dhe zgjeruar ndërmjetësimin financiar me qëllim të rritjes së qasjes së NMV-ve në financa</p>	<p>b.8. Pika e vetme e kontaktit për shërbime, e themeluar dhe funksionale</p> <p>c.1. Bizneset, të mbështetura për të rritur konformitetin e produktit të tyre (certifikimi i produktit) dhe ndërkombëtarizimin e tyre.</p> <p>c.2. Kosova i bashkohet Rrjetit Evropian të Ndërmarrjeve</p> <p>c.3. Kosova merr pjesë në programin COSME për mbështetjen e NVM-ve në lehtësimin e qasjes në financa, përmirësimin e qasjes në tregje dhe rritjes së konkurrencës dhe kulturës ndërmarrëse</p> <p>d.1 Miratimi i ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare</p> <p>d.2. Futja në funksion e Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive (FKGK)</p>	<p>c.1. K4 2017</p> <p>c.2. K3 2017</p> <p>c.3. K3 2017</p> <p>d.1. K3 2017</p> <p>d.2. K4 2017</p>	
2.5	Zhvillimi i mëtejshëm i disa statistikave sektoriale, kyçe për politikë bërje në fushën e llogarive kombëtare, statistikave të biznesit, statistikave të energjisë dhe atyre sociale	<p>1. Vonesat e publikimit, të reduktuara për PBB-të vjetore dhe tremujore përkatëse dhe statistikave të llogarive të qeverisë, përfshirë këtu publikimin në kohë të statistikave financiare të qeverisë me metodologjinë e ESA 2010;</p> <p>2. Prodhimi dhe publikimi i statistikave afatshkurtra të biznesit, të përmirësuara (vëllimit të prodhimit industrial dhe indekset e çmimeve);</p>	<p>1. K4/2017 për PBB-të tremujore të 2018 për PBB-të dhe SFQ-të vjetore</p> <p>2. K4 2017 Indeksi i Prodhimit Industrial</p>	ASK

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Afatet kohor	Institucionet përgjegjëse
		3. Rezultatet nga statistikat e Anketës së Fuqisë Punëtore, të shpërndara në baza tremujore, dhe cilësia e tyre, e përmirësuar; 4. Anketa mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës, e kryer; 5. Publikimi i statistikave të energjisë, të reduktuara dhe statistikat vjetore të eficiencës së energjisë, të prodhuara në përputhje me standardet ndërkombëtare;	3.K4 2017 4. K4 2017 5. K4 2018	
2.6	<p>Përmirësimi i lidhjes rajonale</p> <p>a) Zbatimi i projekteve të investimeve publike individuale me prioritet, në veçanti duke miratuar raportin e rishikuar të zbatimit të klauzolës së investimeve, në bazë të "Listës prioritare të projekteve infrastrukturore"</p> <p>b) Zbatimi i të gjitha 'masave të buta' të mbetura të lidhjes, dhe reformat përkatëse të politikave mbi transportin dhe energjinë</p>	<p>a. 1 Qeveria miraton raportin e rishikuar mbi zbatim, për klauzolën e investimeve;</p> <p>a.2. Numri i marrëveshjeve financiare, i ratifikuar në Kuvend në lidhje me projektet brenda Klauzolës së Investimeve, e aprovuar nga KKI dhe Qeveria;</p> <p><u>Energjia</u></p> <p>6.b.i. Legjislacioni dytësor që rrjedh nga ai primar, i miratuar;</p> <p>6.b.ii Çmimet e parregulluara të energjisë:</p> <p>1. Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së), e ndryshuar dhe miratuar;</p> <p>2. Rregulla për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike (Rregulla për Çmimet e FPPEE-së), e miratuar;</p> <p>3. Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të transmisionit</p>	<p>6. a.1. K4 2016</p> <p>6.a.2. K4 2017</p> <p>6.b.i. K2 2017</p> <p>6.b.ii. K2 2017</p>	<p>MIE MF</p> <p>MZHE MI ZRRE KOSTT</p>

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Afatet kohor	Institucionet përgjegjëse
		<p>dhe të tregut (Rregulla për Çmimet e OST/OT-së), e miratuar;</p> <p>6.b.iii. Tregu i përbashkët energjetik me Shqipërinë, i krijuar;</p> <p>6.b.iv. Tregu i aksioneve energjetike me Shqipërinë - KOSTT (një ditë përpara dhe brenda ditës), i krijuar;</p> <p>6.b.v. Furnizuesit e rinj të energjisë elektrike, të krijuar;</p> <p>6.b.vi. Marrëveshja ndërmjet KOSTT-EMS, e zbatuar;</p> <p>6.b.vii. Kodi i rrjetit të KOSTT-it, i harmonizuar me atë të ENTSO-E.</p> <p><u>Transporti</u></p> <p>6.b.1. Hapja e tregut të transportit;</p> <p>6.b.1.1. Zbatimi i strategjisë së reformës hekurudhore;</p> <p>6.b.2. Krijimi i një sistemi konkurrues, të besueshëm dhe të sigurt sa i përket transportit;</p> <p>6.b.2.1 Përmirësimi i sigurisë në rrugë. Synimi i uljes së objekteve me 20% krahasuar me vitin e referuar 2014;</p> <p>6.b.2.2. Lehtësimi i tregtisë dhe transportit;</p> <p>6.b.2.3. Vendosja e sistemit inteligjent të transportit (SIT) në Rrjetin Kryesor;</p> <p>6.b.2.4. Krijimi i sistemit funksionues të mirëmbajtjes, duke siguruar që asnjë seksion të mos ketë gjendje të keqe/shumë të keqe;</p> <p>6.b.3 Rritja e efektivitetit të Procedurave të kalimit të kufirit;</p> <p>6.b.3.1. Marrëveshjet efektive të kalimit</p>	<p>6.b.iii.K4 2016</p> <p>6.b.iv. K4 2016</p> <p>6.b.v. K4 2016</p> <p>6.b.vi. K4 2016</p> <p>6.b.vii. K4 2016</p> <p>6.b.1. K2 2017</p> <p>6.b.1.1. K2 2017</p> <p>6.b.2. K2 2017</p> <p>6.b.2.1 K2 2017</p> <p>6.b.2.2 K2 2017</p> <p>6.b.2.3 K2 2017</p> <p>6.b.2.4. K2 2017</p> <p>6.b.3. K2 2017</p> <p>6.b.3.1. K2 2017</p>	<p>MI</p> <p>MTI</p> <p>MPB</p> <p>MF</p>

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Afatet kohor	Institucionet përgjegjëse
		kufitar; 6.b.3.2. Zbatimi i strategjisë për Menaxhimin e integruar të kufirit (MIK);	6.b.3.2. K2 2017	
2.7	<p>2.7. Rritja e sigurisë së energjisë dhe miratimi i strategjisë gjithëpërfshirëse të energjisë për periudhës 2017-2026</p> <p>a. Vendosja për modalitetet e pronësisë për Kosova B dhe për investimet e reja në gjenerimin e energjisë, dhe dekomisionimi i Kosova A</p> <p>b. Miratimi i Planit të Veprimit të përditësuar mbi burimet e ripërtërishme</p> <p>c. Vlerësimi i modaliteteve më të mira për krijimin e mekanizmit për financimin e efijencës së energjisë dhe masat mjedisore në sektorin publik dhe atë të rezidencial, dhe nxitja e përdorimit të plotë të iniciativave ekzistuese siç është Programi Rajonal për Efijencë</p>	<p>7. Miratimi i një strategjie gjithëpërfshirëse të energjisë për periudhën 2016-2025 e cila është në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale të BE-së</p> <p>7.a. i. Vendimet për modalitetet e pronësisë së Kosova B, të marra;</p> <p>7.a.ii. Investimet e reja në gjenerimin e energjisë (të gjitha burimet);</p> <p>7.a.iii. Afati i fundit për dekomisionimin e Kosovës A, të jetë fiks;</p> <p>7.b.i. Raporti i dytë mbi ecurinë e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për BRE, i përgatitur;</p> <p>7.b.ii. Miratimi i planit për burimet e ripërtërishme, i përditësuar, duke përfshirë masat e duhura për të siguruar që Kosova po arrin 25% të objektivave të energjisë së ripërtërishme në vitin 2020;</p> <p>7.c.i. Misioni i TAIEX për të vlerësuar modalitetet e mekanizmit të financimit për efijencën e energjisë dhe masat e marra mjedisore;</p> <p>7.c.ii. Vlerësimi dhe marrja e vendimeve për modalitetet e mekanizmit të financimit për të mbështetur investimet në efijencën e energjisë dhe mjedisit;</p>	<p>7. K4 2016</p> <p>7.a.i. K4 2017</p> <p>7.a.ii:K4 2017</p> <p>7.a.iii. K1 2017</p> <p>7.b.i. K1 2017 7.b.ii. K3 2017</p> <p>7.c.i. K1 2017</p> <p>7.c.ii. K3 2017</p>	<p>MZhE MMPH</p>

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Afatet kohor	Institucionet përgjegjëse
		7. c.iii. Miratimi i planit të veprimit 2016-2018 mbi eficiencën e energjisë; 7.c.iv. Miratimi i ligjit mbi performancën e energjisë në ndërtesa; 7.c.v. Miratimi i legjislacionit sekondar, që transpozon Direktivën 2010/31/EU nëpërmjet a) Rregullores për përcaktimin e performancës minimale të energjisë në ndërtesat e reja të banimit, ndërtesat nën renovim dhe llojet e tjera të ndërtesave të banimit, b) Rregullores për certifikatën e performancës së energjisë për ndërtesat e reja dhe ndërtesave të tjera c) Rregullores për inspektimin e sistemit të ngrohjes dhe pajisjeve për kondicionimin e ajrit;	7.c.iii. K4 2016 7.c.iv. K4 2016 7.c.v. K2 2017	
III. Punësimi dhe arsimi				
3.1	Miratimi dhe zbatimi i Strategjisë Sektoriale për Punësimin dhe Politikën Sociale 2015- 2020 dhe miratimi i Planit të Veprimit 2017-2018 për zbatimin e strategjisë	1. Strategjia Sektoriale është hartuar dhe konsultuar me aktetë përkatës, përfshirë komunitetin e donatorëve; 2. Strategjia Sektoriale dhe Plani i saj i Veprimit, të miratuara. 3. Buxheti për zbatimin e strategjisë është ndarë.	1. K4 2016 2. K2 2017	MPMS MKRS MASHT
3.2	a) Krijimi i një plani të veprimit për trajtimin papunësisë tek të rinjtë në bazë të një vlerësimi të sfidave dhe duke u fokusuar në përmirësimin e rezultateve të arsimit dhe mbështetjen e kalimit nga shkolla në punë b) Ndërmarrja e masave për rritjen e pjesëmarrjes	a.1 Plani i veprimit me tregues të qartë për trajtimin e papunësisë tek të rinjtë, është hartuar a.2 Draft Plani i veprimit është konsultuar me aktetë përkatës, përfshirë komunitetin e donatorëve a.3 Plani i veprimit me tregues të qartë për trajtimin e papunësisë tek të rinjtë, është miratuar	a.1 K4 2016 a.2 K1 2017 a.3 K1 2017	MPMS

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Afatet kohor	Institucionet përgjegjëse
	së grave në tregun e punës.	b.1 Rritet asistenca e pranuar nga gratë nga shërbimi i punësimit b.2 Draft analiza e pengesave në punësimin e femrave është bërë në konsultime me akterët relevant b.3 Përdorimi i analizës për zhvillimin e masave të duhura për përmirësimin e papunësisë së grave	b.1 K1 2017 b.2 K2 2017 b.3 K3 2017	
3.3	Sigurimi i zbatimit të ligjit mbi agjencinë e punësimit, në veçanti nëpërmjet funksionalizimit të agjencisë për punësim dhe ndarjes së buxhetit të nevojshëm për të siguruar që është në gjendje të iniciojë masat aktive të tregut të punës me rezultate të prekshme.	1. Realizimi i një vlerësim të nevojave të tregut të punës (përfshirë mbi AAP) 2. Përzgjedhja e Drejtorit të Agjencisë së Punësimit dhe Bordit Këshillues është përfunduar dhe rregulloret e punës për Agjencinë e Punësimit janë miratuar; 3. Masat aktive të tregut të punës janë zbatuar nga Agjencia e Punësimit (thirrjet për aplikime janë lansuar, mbështetja financiare është dhënë sipas rezultateve të thirrjeve);	1. K1 2017 2. K4 2016 3. K2 2017	MPMS
3.4	Miratimi i legjisllacionit të mbetur që ofron bazën për reforma të politikave në sektorin e arsimit	1. Projektligji i rishikuar mbi arsimin e lartë, i miratuar; 2. Projektligji mbi profesionet e rregulluara në Kosovë, është miratuar; 3. Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021 është miratuar nga qeveria dhe është ndarë buxheti i nevojshëm për të siguruar zbatimin e tij;	1. K1 2017 2. K2 2017 3. K4 2016	MASHT
3.5	Përmirësimi i cilësisë së arsimit nëpërmjet: a. Rritjes së vijueshmërisë së arsimit parashkollor b. Realizimi i vlerësimit/vlerësimit të jashtëm dhe përshpejtimi i zbatimit të kurrikulave të reja, përfshirë me tekstet e reja shkollore në arsimin	a.1 Numri i objekteve publike për kujdesin ndaj fëmijëve të moshës 0-5 vjeç është rritur b.1. Kurrikula bërthamë për arsimin parashkollor është zhvilluar dhe ka filluar faza e saj e pilotimit	a.1. K3 2017 b.1. K4 2017	MASHT

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Afatet kohor	Institucionet përgjegjëse
	<p>para-universitar</p> <p>c. Krijimi i mekanizmave për vlerësimin dhe përmirësimin e programeve të trajnimit fillestar dhe në shërbim të mësimdhënësve.</p> <p>d. Përmirësimi i cilësisë së përgjithshme të arsimit të lartë</p> <p>e. Nxitja e lidhjeve më të mira ndërmjet arsimit të lartë dhe tregut të punës nëpërmjet lehtësimit dhe nxitjes së themelimit të bordeve industriale në universitete të cilat këshillojnë IAL-të mbi</p>	<p>b.2 Korniza e Kurrikulës Bërthamë e Arsimit Para-universitar (i vitit 2011 dhe 2012) është shqyrtuar dhe aprovuar dhe rezultatet e të nxëniet për lëndët dhe klasat është janë zhvilluar në shkolla;</p> <p>b.3 Korniza e Kurrikulës Bërthamë për Arsimin Para-Universitar dhe syllabusi për klasat dhe lëndët është shqyrtuar dhe aprovuar me zbatimin të mëpasshëm në të gjitha shkollat, duke filluar nga viti shkollor 2017/2018;</p> <p>c.1. Mekanizmat për sigurimin e cilësisë të zhvilluara përmes emërimit të koordinatorëve të cilësisë në shkolla dhe krijimit të sistemit efikas për vlerësimin e performancës në shkolla;</p> <p>c.2. Agjencia për Kurrikulë, Standarde dhe Vlerësim është themeluar dhe është plotësisht funksionale;</p> <p>c.3. Projektligji i rishikuar mbi inspektoratin e arsimit në Kosovë është miratuar nga Kuvendi dhe inspektorët kanë filluar aktivitetet e tyre, me inspektorë dhe kapacitete të mjaftueshme</p> <p>d.1. Krijimi dhe funksionalizimi i Këshillave Industriale</p> <p>d.2. Shqyrtimi i programeve studimore dhe politikave të regjistrimit</p> <p>e.1 Projekt propozimi mbi themelimin e bordeve industriale në universitete që këshillojnë IAL-të, është prezantuar</p> <p>e.2 Propozimi mbi themelimin e bordeve</p>	<p>b.2. K2 2017</p> <p>b.3. K4 2017</p> <p>c.1. K2 2017</p> <p>c.2. K2 2017</p> <p>c.3. K4 2017</p> <p>d.1 K2 2017</p> <p>d.2 K3 2017</p> <p>e.1 K1 2017</p> <p>e.2 K3 2017</p>	

Nr.	Prioritetet	Veprimet dhe treguesit	Afatet kohor	Institucionet përgjegjëse
	rëndësinë e kurrikulave mësimore, identifikimi i mangësive në shkathtësitë e të diplomuarve, pjesëmarrja në trajnim dhe mësimdhënie (vizita, seminare) dhe ofrimi i trajnimeve dhe përvojë në punë praktike për studentët	industriale në Universitete që këshillojnë IAL-të shkon në konsultime publike e.3 Propozimi mbi themelimin e bordeve industriale në Universitetet që këshillojnë IAL-të është miratuar dhe fillon zbatimin	e.3 K3 2017	
3.6	Përmirësimi i cilësisë së Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (AAP) dhe kalimit nga shkolla në punë	<p>a.1 Vlerësimi i Nevojave të Tregut të Punës (ë bërë në pikën 3.3) përdoret si bazë.</p> <p>a.2 Përmirësimi i cilësisë së sistemit të aftësisimit profesional përmes harmonizimit të AAP me nevojat e tregut të punës përmes shqyrtimit të profileve të ofruara në shkollat e AAP-së dhe përafrimit të saj me vlerësimin e nevojave të tregut të punës</p> <p>a.3 Hartimi i kurrikulave bërthamë për AAP dhe fillimi i fazës së pilotimit</p> <p>a.4 Sigurimi i financimit të duhur për qendrat e AAP-së</p> <p>b.1 Përmirësimi i rezultateve të arsimit dhe mbështetja e shkollave për kalim në tregun e punës përmes sigurimit të praktikave me punëdhënësit, janë zgjeruar dhe përfshirë në programet studimore</p>	<p>a.1 K1 2017</p> <p>a.2 K3 2017</p> <p>a.3 K2 2017</p> <p>a.4 K3 2017</p> <p>b.1 K3 2017</p>	MASHT KKK Agjencia e Punësimit